

L I G J
Nr.8242, datë 16.9.1997

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7786, DATË 27.1.1994 "PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT PERSONALE", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8091, DATË 21.3.1996**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7786, datë 27.1.1994 "Për tatimin mbi të ardhurat personale", ndryshuar me ligjin nr.8091, datë 21.3.1996, neni 6 ndryshohet si vijon:

"Tatimi mbi të ardhurat personale për veprat krijuese dhe për të ardhurat nga qiratë e banesave është 5 për qind, për të ardhurat nga qiratë e dyqaneve, magazinave, truallit dhe objekteve të tjera është 20 për qind dhe për llojet e tjera të të ardhurave personale është 10 për qind".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi më datën 1 tetor 1997.

Shpallur me dekretin nr.1941, datë 20.9.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani